



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR AD HOC

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

E-mail: info@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 107/2 Prot

Tiranë 27 /09/2023

V E N D I M

Nr. 02, Datë 27/09/ 2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
"PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PAVARUR AD HOC
PËR VERIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN PARAPRAK TË KANDIDATËVE,
PËR PLOTËSIMIN E VAKANCAVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E LARTË
GJYQËSOR, SI DHE KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË,
NGA RADHËT E AVOKATËVE

Mbështetur në nenet 34, pika 6 dhe 132, pika 6, të ligjit nr.115/2016, "Për organet e Qeverisjes së sistemit të Drejtësisë",

VENDOSËM:

1. Miratimin e Rregullores "Për funksionimin e Komisionit të Pavarur Ad Hoc, për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, si dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve"
2. Ky Vendim, së bashku me tekstin e Rregullores, të publikohen menjëherë në faqen zyrtare web të institucionit të Avokatit të Popullit.
3. Ndjekja e zbatimit të këtij Vendimi, të bëhet nga kryetari i këtij Komisioni.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Avokati i Popullit
KRYETAR

Erinda BALLANCA

Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi
ZEVENDËSKRYETAR

Sandër SIMONI

**Përfaqësues të Dhomës së Avokatisë
ANËTARË**

Z. Maksim HAXHIA




z. Ilir DODE



**Përfaqësuesi i Akademisë së Shkencave
ANËTAR**

Z. Shaban SINANI



Tiranë, më 27/09/ 2023

RREGULLORE

**“PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PAVARUR *AD HOC*
PËR VERIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN PARAPRAK TË
KANDIDATËVE
PËR PLOTËSIMIN E VAKANCAVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E
LARTË GJYQËSOR, SI DHE KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË,
NGA RADHËT E AVOKATËVE”**

PËRMBLEDHJE

KREU I

Dispozitat e Përgjithshme fq.2

KREU II

Seksioni 1

Konstituimi i Komisionit, mandati i anëtarëve dhe detyrimet e tyre fq.3

Seksioni 2

Kriteret për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve fq.9

Seksioni 3

Transparenca dhe komunikimi fq.11

Seksioni 4

Veprimtaria përgatitore dhe mbështetëse për Komisionin fq.11

RREGULLORE
PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PAVARUR AD HOC
PËR VERIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN PARAPRAK TË KANDIDATËVE
PËR PLOTËSIMIN E VAKANCAVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E LARTË
GJYQËSOR, SI DHE KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË,
NGA RADHËT E AVOKATËVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullores

Kjo Rregullore përcakton rregullat e funksionimit të Komisionit të pavarur *ad hoc* për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, si dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve, në realizimin e mbledhjeve dhe veprimtarinë e tij, sipas detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo Rregullore nxirret në bazë të neneve 34, pika 6 dhe 132, pika 6, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e Qeverisjes së sistemit të Drejtësisë".

Neni 3
Përkufizime

1. Për qëllim të kësaj Rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Komisioni" është Komisioni i pavarur *ad hoc* i për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, si dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve, në ushtrim të kompetencave në mbledhjet ose në veprimtarinë e tij, të përcaktuara në ligjin nr.115/2016 "Për organet e Qeverisjes së sistemit të Drejtësisë", si dhe akte të tjera normative në fuqi;
- b) "Kandidatë" janë, sipas rastit, personat që kandidojnë për t'u zgjedhur anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe/ose në Këshillin e Lartë të Prokurorisë;
- ç) "Papajtueshmëria" përfshin marrëdhëniet që ekzistojnë ndërmjet anëtarit të Komisionit dhe kandidatit në rastet e përcaktuara nga neni 28 i ligjit nr.115/2016;
- c) "Konflikt i interesit" përfshin të gjitha gjendjet dhe rastet e parashikuara nga nenet 28 dhe 29 të ligjit nr.115/2016 , si edhe nga dispozitat e ligjit nr. 9367/2005;
- dh) "Pengesë ligjore" përfshin të gjitha gjendjet dhe rastet e parashikuara nga neni 30 i Kodit të Procedurave Administrative;
- d) "Pamundësi objektive" përfshin të gjitha rastet kur anëtari i Komisioni është në mungesë për shkaqe të përlegjura në përmbushjen e detyrimeve të tij për mbledhjet dhe veprimtarinë e Komisionit.

Neni 4
Selia e Komisionit

1. Selia e Komisionit është në institucionin e Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë në adresën: Blv. "Zhan D'Ark", Nr. 2, Tiranë, Shqipëri.

2. Mbledhjet e Komisionit zhvillohen në institucionin e Avokatit të Popullit, i cili siguron mbështetjen e nevojshme organizative, administrative dhe financiare për realizimin e funksionit dhe të detyrave të Komisionit.
3. Edhe në rastet e mbledhjeve online, struktura teknike për realizimin e mbledhjes dhe personat përgjegjës për menaxhimin e aparaturave përkatëse, do të jenë në institucionin e Avokatit të Popullit.

KREU II **FUNKSIONIMI I KOMISIONIT**

Seksioni 1

Konstituimi i Komisionit, mandati i anëtarëve dhe detyrimet e tyre

Neni 5

Konstituimi i Komisionit

1. Konstituimi i Komisionit deklarohet në mbledhjen e parë të tij.
2. Sipas neneve 23 dhe 121 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e Qeverisjes së sistemit të Drejtësisë":
 - Komisioni është i përbërë nga:
 - a) Avokati i Popullit;
 - b) Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi;
 - c) dy avokatë, më i riu dhe më i vjetri në moshë ndër avokatët që plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që nuk kandidojnë dhe që janë angazhuar gjatë 5 viteve të fundit në mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës ose në Shkollën e Avokatisë;
 - ç) një anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave nga shkencat shoqërore, i zgjedhur me shumicë të thjeshtë nga Asambleja e Akademisë së Shkencave.
 - Avokati i Popullit është kryetar i Komisionit të Pavarur *Ad Hoc*, ndërsa kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është zëvendëskryetar i komisionit.
3. Mbledhja e parë e Komisionit thirret nga jo më vonë se 10 ditë nga dita e paraqitjes së shprehjeve të interesit dhe regjistrimit të kandidatëve.
4. Në mbledhjen e parë të Komisionit marrin pjesë të gjithë anëtarët, si dhe anëtarët zëvendësues.
5. Mbledhja e parë e Komisionit miraton Rregulloren për funksionimin e Komisionit, e cila miratohet me shumicë të thjeshtë votash. Anëtarët zëvendësues nuk marrin pjesë në miratimin e Rregullores.

Neni 6

Mandati i anëtarit dhe anëtarit zëvendësues të Komisionit

1. Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Komisionit qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjen nga Kuvendi të kandidatëve për vakancën e shpallur.
2. Në rast të pezullimit, ndërprerjes, apo mbarimit të funksionit, përfaqësuesit e Komisionit, zëvendësohet nga anëtari zëvendësues sipas ligjit.

Neni 7

Detyrimi i pjesëmarrjes në mbledhjet dhe veprimtaritë e Komisionit

1. Pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit në mbledhjet dhe veprimtaritë e tij është e detyrueshme përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të kësaj detyre.

2. Anëtarët e Komisioni që janë në pamundësi objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengesë ligjore zëvendësohen nga anëtarët përkatës zëvendësues sipas ligjit, të cilët në raste të tilla, gjithashtu janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet dhe veprimtaritë e Komisionit.

Neni 8

Përgatitja e mbledhjeve të Komisionit

1. Në përgatitjen e mbledhjeve të Komisionit dhe përcaktimin e çështjeve të rendit të ditës, Kryetari dhe anëtarët e Komisionit vlerësojnë rëndësinë dhe përparësinë e çështjeve, veçanërisht nisur nga rastet dhe nevojat e Komisionit për të respektuar afatet, procedurat dhe detyrimet e tjera ligjore, si edhe detyrat e përcaktuara nga vendimmarrjet përkatëse të mbledhjeve të mëparshme të Komisionit.
2. Përcaktimi i çështjeve të rendit të ditës dhe caktimi i ditës së zhvillimit të mbledhjes së Komisioni bëhet nga Kryetari, duke mbajtur parasysh mendimin e anëtarëve dhe detyrat e lëna në mbledhjet e mëparshme. Në rendin e ditës përfshihen edhe çështjet që mund të propozohen, me shkrim, nga secili prej anëtarëve të Komisionit.
3. Nëse dita e mbledhjes së Komisionit është paracaktuar në mbledhjen paraardhëse, njoftimi i anëtarit për çështjet e tjera që duhet të përfshihen në rendin e ditës, duhet të paraqitet jo më vonë se dy ditë nga dita e caktuar për zhvillimin e mbledhjes.
4. Për përgatitjen e çështjeve të rendit të ditës dhe të dokumentacionit përkatës, kryetari i Komisionit, mbështetet nga personeli administrativ i institucionit të Avokatit të Popullit.

Neni 9

Thirrja e mbledhjeve të Komisionit

1. Komisioni mblidhet sa herë është e nevojshme.
2. Mbledhja paraardhëse e Komisionit, përpara përfundimit të saj, diskuton dhe vendos, nëse është e mundur, për rendin e ditës, datën dhe kohën e zhvillimit të mbledhjes pasardhëse.
3. Nëse nuk është vendosur ndryshe nga mbledhja e mëparshme e Komisionit, mbi bazën e punës përgatitore dhe propozimeve të tjera eventuale të anëtarëve, kryetari thërret mbledhjen dhe vendos rendin e ditës, datën dhe kohën e zhvillimit të saj.
4. Në rastet kur kërkohet me shkrim, nga të paktën shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Komisionit, kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Komisioni në datën, kohën dhe me rendin e ditës të përcaktuar nga anëtarët nismëtarë.
5. Në pamundësi objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengesë ligjore të kryetarit, veprimet përgatitore dhe thirrja e mbledhjes kryen nga zëvendëskryetari.
6. Në pamundësi objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengesë ligjore si të kryetarit ashtu edhe të zëvendëskryetarit, mbledhja e Komisionit mund të thirret nga një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij, të cilët propozojnë edhe datën, kohën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Në këtë rast, puna përgatitore dhe mbledhja e Komisionit drejtohet nga anëtari i Komisionit më i vjetër në moshë.
7. Kryetari përcakton në njoftimin e thirrjes së mbledhjes nëse për shqyrtimin e çështjeve të rendit të ditës, Komisioni do të qëndrojë i mbledhur për një kohë më të gjatë se dita e caktuar për fillimin e mbledhjes. Në këto raste, Komisioni qëndron i mbledhur deri në përfundim të shqyrtimit të çështjeve, veçanërisht nëse ky detyrim përcaktohet nga ligji apo kur nisur nga natyra komplekse dhe e ndërvarur e çështjeve, nevojitet përfundimi i shqyrtimit të tyre në funksion të respektimit të afateve dhe detyrimeve të caktuara ligjore.

Neni 10

Njoftimet për thirrjen e mbledhjes së Komisionit

1. Nëse nuk është vendosur ndryshe në mbledhjet e mëparshme të Komisioni, njoftimi për thirrjen e mbledhjes, bëhet së paku dy ditë përpara datës që caktohet për zhvillimin e saj.
Thirrja dhe njoftimi i mbledhjes bëhet edhe përpara këtij afati, nëse lind nevoja për të respektuar procedurat dhe afatet e caktuara nga ligji, si edhe në varësi të rrethanave dhe natyrës së çështjes.
2. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes përmban: datën, kohën e zhvillimit të mbledhjes, rendin e ditës dhe i dërgohet të gjithë anëtarëve të Komisionit.
3. Së bashku me njoftimin për thirrjen e mbledhjes, sipas rasteve dhe natyrës së çështjeve të rendit të ditës, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme të komunikimit (e-mail, ose me postë), anëtarëve të Komisionit u dërgohet edhe dokumentacioni përkatës.
4. Në rastet kur përpara ditës së caktuar për zhvillimin e mbledhjes apo për thirrjen e saj, kryetari ka ardhur në dijeni të pamundësisë objektive ose të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit apo të pengesës të anëtarit të Komisionit për të marrë pjesë në mbledhje, ose për çështje të caktuara të rendit të ditës, për shkak të heqjes dorë, ose përjashtimit për motivet të parashikuara nga ligji, dokumentacioni përkatës i përgatitur, i dërgohet menjëherë anëtarit zëvendësues të Komisionit, së bashku me njoftimin për të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit.
5. Në rastet kur pas thirrjes së mbledhjes, njoftohet nga anëtari i Komisioni ose vjen në dijeni edhe kryesisht, lidhur me pamundësinë objektive të pjesëmarrjes së tij në mbledhje, kryetari procedon menjëherë me njoftimin e dytë të posaçëm të anëtarit zëvendësues për këtë rrethanë dhe për detyrimin e këtij të fundit për të marrë pjesë në mbledhje, duke i dërguar edhe dokumentacionin përkatës të përgatitur.
6. Anëtari i Komisioni dhe/ose anëtari zëvendësues, menjëherë pas njoftimit të mbledhjes ose në çastin kur vjen në dijeni të rrethanave konkrete të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit apo pengesës ligjore, lidhur me çështjet e rendit të ditës, apo një pjese të tyre, duhet të njoftojë menjëherë kryetarin, duke i parashtruar edhe kërkesën e arsyetuar me shkrim me vlerësimin e tij për motivet e ekzistencës së këtyre shkaqeve.
7. Në rastet kur Kryetari njoftohet nga anëtari i Komisioni lidhur me rrethana konkrete të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit apo pengesës ligjore për pjesëmarrjen e tij në mbledhje ose për çështje të caktuara të saj, Kryetari vepron menjëherë sipas ligjit për të disponuar pranimin ose jo të kërkesës së heqjes dorë apo mbi përjashtimin e tij. Në rast të pranimit të heqjes dorë ose të vendimit të përjashtimit, Kryetari procedon menjëherë me njoftimin e anëtarit zëvendësues për detyrimin e pjesëmarrjes në mbledhje, duke i dërguar edhe dokumentacionin përkatës të përgatitur nga anëtarët relatorë të çështjeve të rendit të ditës.
8. Njoftimi i anëtarëve të Komisionit për zhvillimin e mbledhjes bëhet përmes shpalljes në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit dhe i dërgohet secilit prej anëtarëve në adresën elektronike të deklaruar dhe me postë.
9. Së bashku me njoftimin për mbledhje dërgohet edhe dokumentacioni përkatës.
10. Mbledhjet e Komisionit janë të mbyllura.

Neni 11

Drejtimi i mbledhjeve të Komisionit

1. Mbledhja e Komisionit drejtohet nga kryetari.
2. Në rast pamundësie objektive ose papajtueshmërie, konflikti të interesit apo pengese ligjore të

kryetarit mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari i Komisioni.

3. Në rast pamundësie objektive ose papajtueshmërie, konflikti të interesit apo pengese ligjore edhe të zëvendëskryetarit, mbledhja e Komisioni drejtohet nga anëtari i pranishëm më i vjetër në moshë.

Neni 12

Pjesëmarrësit në mbledhjet e Komisionit

1. Në mbledhjet e Komisioni marrin pjesë anëtarët e Komisionit. Në pamundësi objektive ose papajtueshmëri, konflikti të interesit apo pengesë ligjore të tyre në mbledhje marrin pjesë anëtarët përkatës zëvendësues.
2. Rast pas rasti, sipas përcaktimeve të legjisllacionit, për nevoja të mbështetjes me konsulencë apo njohuri të posaçme, Komisioni mund të angazhojë dhe thërrasë në mbledhjet e tij, ekspertë apo subjekte me njohuri të posaçme të fushës përkatëse.

Neni 13

Procedura në rast papajtueshmërie dhe konflikti të interesit

1. Anëtari i Komisioni ose anëtari zëvendësues, nëse ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, nuk merr pjesë në veprimtaritë dhe mbledhjet e Komisionit të lidhura me çështje që kanë për objekt diskutimin, verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve, si edhe në procedurat konkrete të shqyrtimit të kandidimeve për pozicionet vakante.
2. Në rastin kur në lidhje me çështje të caktuara që trajtohen në veprimtaritë dhe mbledhjet e Komisionit, anëtari i Komisionit ose anëtari zëvendësues vjen në dijeni të rrethanave të tilla që, sipas ligjit, e vendosin atë vetë ose një anëtar tjetër, përpara njërit prej rasteve të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, njofton menjëherë Kryetarin e Komisionit dhe deklaron arsyet konkrete që sjellin pengesë për pjesëmarrjen në përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e çështjes përkatëse.
3. Në rastin kur në lidhje me çështje të caktuara që trajtohen në veprimtaritë dhe mbledhjet e Komisioni, anëtari i Komisioni ose anëtari zëvendësues janë përpara njërit prej rasteve të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit, ose të pengesës ligjore dhe mospjesëmarrja e tyre sjell pamundësinë e ushtrimit të kompetencave, përfshirë uljen e kuorumit të mbledhjes së Komisioni, atëherë rasti merret në shqyrtim menjëherë nga mbledhja e Komisionit dhe në respektim të parimit të funksionalitetit e për të mos bllokuar veprimtarinë dhe vendimmarrjen e tij, Komisioni vendos për mënyrën e procedimit që garanton ushtrimin e kompetencave të tij.

Neni 14

Kuorumi i mbledhjes së Komisioni

1. Mbledhja e Komisioni zhvillohet kur janë të pranishëm jo më pak se 3 anëtarë të tij, dhe vendos me shumicën e votave.
2. Në rast se në ditën e caktuar nuk sigurohet kuorumi i nevojshëm, Kryetari apo sipas rastit Zëvendëskryetari ose anëtari që drejton mbledhjen, cakton një ditë tjetër sa më të afërt për zhvillimin e mbledhjes, mundësisht brenda 24 orëve dhe njofton për këtë anëtarët e Komisioni që nuk ishin të pranishëm.
3. Në rast të mospjesëmarrjes pa shkaqe të justifikuara në veprimtaritë dhe mbledhjet e Komisionit, si edhe të veprimeve a mosveprimeve që përbëjnë shkelje të tjera disiplinore

sipas ligjit, Komisioni njofton menjëherë institucionet përkatëse që, sipas ligjit, kanë kompetencat për fillimin e procedimit disiplinor ndaj anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues të Komisionit.

Neni 15

Punimet e mbledhjes së Komisionit

1. Kryetari deklaron fillimin e mbledhjes së Komisionit, verifikon prezencën e anëtarëve dhe/ose anëtarëve zëvendësues, duke informuar Komisionin për motivet e mungesës ose të pengesës së anëtarit të Komisionit që nuk është i pranishëm, si edhe për thirrjen në atë mbledhje të anëtarit përkatës zëvendësues të tij.
2. Nëse nuk janë të njohura motivet e mosparaqitjes së anëtarit ose anëtarit zëvendësues, Kryetari ndërpret mbledhjen dhe menjëherë merr masa për ta kontaktuar anëtarin në mungesë, për tu informuar mbi mundësinë e paraqitjes në një kohë të arsyeshme dhe për të rifilluar mbledhjen.
3. Kur verifikohet kuorumi i vlefshëm për zhvillimin e mbledhjes, kryetari paraqet çështjet e përcaktuara për shqyrtim në rendin e ditës. Komisioni merr vendime vetëm për çështjet të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 1/2 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje që nuk janë në rendin e ditës.
4. Pas miratimit të rendit të ditës, nëse anëtarët nuk ngrenë probleme të tjera të lidhura me ndonjërin prej rasteve të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, Komisioni vijon me shqyrtimin e çështjeve.
5. Kryetari i Komisionit drejton debatin dhe përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës.
6. Anëtarët e Komisioni janë të detyruar të marrin fjalën lidhur me secilën çështje të rendit të ditës.
7. Kryetari kujdeset që fjala të merret sipas radhës, si rregull, pa ndërprerje dhe debate të ndërmjetëm mes anëtarëve të Komisionit, përveç kur në mbledhje kërkohet të parashtrohet një çështje procedurale për mënyrën e zhvillimit të saj.
8. Për secilën çështje të rendit të ditës, i pari e merr fjalën, kryetari i Komisionit, më pas zëvendëskryetari dhe më pas anëtarët.
9. Në vijim, nëse vlerësojnë të marrin përsëri fjalën, nën drejtimin e kryetarit, anëtarët e Komisionit debatojnë lirisht pa ndonjë radhë të paracaktuar diskutimi.
10. Pas mbylljes së diskutimeve mes tyre, anëtarët e Komisioni shprehin qëndrimin dhe votojnë për çështjen. Kryetari i Komisionit shpreh qëndrimin dhe voton i fundit.
11. Komisioni vendos me shumicën e votave në prani të të paktën tre anëtarëve. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.
12. Vendimet e komisionit “Ad hoc” merren me votim të hapur.
13. Kryetari i Komisionit, përpara përfundimit të mbledhjes, propozon për diskutim ditën dhe kohën e zhvillimit të mbledhjes së ardhshme, si edhe çështjet e mundshme të rendit të ditës. Pasi Komisioni vendos për mënyrën se si do të procedohet, kryetari deklaron mbylljen e mbledhjes.
14. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligjin nr.115/2016 dhe për aq sa nuk është parashikuar ndryshe në këtë ligj, edhe në legjislationin për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale, ose Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 16

Kompetencat e kryetarit

1. Kryetari i Komisionit drejton dhe bashkërendon punën dhe veprimtarinë e Komisionit në zbatim:
 - a) të kompetencave dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 115/2016;
 - b) të parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm për veprimtarinë e organeve kolegjiale;
 - c) kësaj Rregulloreje, apo detyrave të tjera të ngarkuara me vendim nga mbledhjet e Komisionit.
2. Kryetari i Komisionit, në zbatim të kompetencave dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni:
 - a) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Komisionit;
 - b) koordinon veprimtaritë administrative në mbështetje të ushtrimit të kompetencave të Komisionit;
 - c) përfaqëson Komisionin në marrëdhëniet me të tretët, duke përfshirë, por jo kufizuar këto marrëdhënie në bashkëpunime me institucionet e tjera, organet publike, organizata ndërkombëtare;
 - ç) nënshkruan vendimet dhe çdo akt tjetër që lidhet me ushtrimin e kompetencave të Komisioni dhe shkresat e ndryshme për komunikimin e këtij Komisioni me të tretët;
 - d) për kontrollin e integritetit të kandidatëve, i përcjell menjëherë Prokurorisë së Përgjithshme formularët e vetëdeklarimit, të plotësuar nga kandidatët, sipas kërkesave të ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
 - dh) për kontrollin e kushteve të tjera ligjore, dërgon kërkesa me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private, sipas nevojës.
 - dh) për kontrollin e plotësimit të kushteve të parashikuara nga shkronjat “c” deri në “e”, të nenit 19, të ligjit nr. 115/2016, nëse është e nevojshme, i drejtohet Dhomës Kombëtare të Avokatisë për saktësimin e informacionit të deklaruar nga kandidati.
 - ë) në përfundim të procesit të vlerësimit, i përcjell Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit një listë me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta, por jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante.
2. Në pamundësi objektive a pengesë ligjore të kryetarit, këto funksione ushtrohen nga zëvendëskryetari i Komisionit.

Neni 17

Dokumentimi i mbledhjes

1. Kryetari i Komisionit është përgjegjës për të siguruar që personeli administrativ i institucionit të Avokatit të Popullit të marrë masat e nevojshme që çdo mbledhje e Komisioni të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme përmes:
 - a) regjistrimit audio të mbledhjes;
 - b) regjistrimit të plotë të mbledhjes (audio dhe video), në se mbledhja e Komisionit është online.
2. Kryetari i Komisioni ngarkon të paktën një nëpunës nga institucioni i Avokatit të Popullit, në cilësinë e sekretariatit, për të mbajtur procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes së Komisionit.
3. Në varësi edhe të natyrës së çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e Komisionit, procesverbali i përmbledhur i mbledhjes do të përmbajë:
 - a) datën dhe orën e fillimit e të mbarimit të mbledhjes;

- b) çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës;
 - c) anëtarët e Komisionit dhe/ose anëtarët zëvendësues të pranishëm;
 - ç) subjekte të tjerë të thirrur apo të ftuar, kur kanë qenë të pranishëm;
 - d) veprimet procedurale të zhvilluara në mbledhjen e Komisionit;
 - dh) rezultatet e votimit dhe dispozitivin e vendimeve të Komisionit lidhur me procedurat e verifikimit, vlerësimit dhe renditjes së kandidaturave;
 - e) rezultatin e votimit mbi çdo vendim dhe qëndrim tjetër të mbajtur gjatë punimeve të mbledhjes së Komisionit.
4. Procesverbal i përmbledhur, i dërgohet kryetarit të Komisionit, i cili në rast se ka dyshime për saktësinë e përmbledhjes së procesverbalit, urdhëron ballafaqimin e përmbledhjes me regjistrimin audio dhe ndryshimin e saj në qoftë se dyshimi rezulton i justifikuar.
 5. Ky procesverbal i përmbledhur, shërben si bazë për njoftimin për shtyp, që do të bëhet pas çdo mbledhjeje, në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit.
 6. Procesverbal i përmbledhur, së bashku me regjistrimin audio apo video të mbledhjes, depozitohen për ruajtje sipas legjislacionit në fuqi mbi arkivat, në zyrën e protokoll/arkivës të institucionit të Avokatit të Popullit.
 7. Kopje e këtyre dokumentave mund tu vihen në dispozicion anëtarëve të Komisionit, me kërkesë të tyre.

Neni 18 **Mbledhjet online**

1. Në rast se ndonjë nga anëtarët e Komisionit nuk ka mundësi të marrë pjesë fizikisht, ai mund të bëjë kërkesë për të ndjekur mbledhjen online. Kjo kërkesë shqyrtohet menjëherë pas hapjes së mbledhjes dhe në rast miratimi, e gjithë mbledhja duhet të regjistrohet e plotë me audio.
2. Kjo dispozitë mund të zbatohet edhe kur asnjë nga anëtarët e Komisionit nuk ka mundësi të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

Seksioni 2 **Kriteret për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve**

Neni 19 **Shqyrtimi, dëgjesa dhe renditja e kandidatëve**

Jo më vonë se 45 ditë nga dita kur përfundon afati për dorëzimin e shprehjeve të interesit për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisioni verifikon plotësimin e kushteve ligjore nga kandidatët.

1. Shqyrtimi i relacionit të grupit ad hoc ngritur nga Avokati i Popullit

Me qëllim mbështetjen e Avokatit të Popullit në ushtrimin e kompetencave ligjore, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve dhe shoqërisë civile, si dhe delegimin e kompetencës për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët për këto vakanca, Avokati i Popullit me Urdhërin nr. 113 datë 24.07.2023 ka krijuar një grup pune *ad-hoc*.

Ky grup pune në përfundim të verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët, (përfshirë edhe dokumentacionin plotësues për rastet kur plotësimi i kushteve ligjore ishte konsideruar i paplotë), ka hartuar Relacionin përkatës i cili i është paraqitur kryetarit të Komisionit ad hoc dhe ky i fundit ja përcjell Komisionit.

2. Verifikimi i plotësisimit të kushteve ligjore

Mbi bazën e dokumentacionit të depozituar nga kandidatët, duke patur parasysh Relacionin e hartuar nga grupi ad-hoc i sipërcituar, si dhe përgjigjet e kthyer nga institucionet e tjera, Komisioni verifikon plotësimin e kushteve ligjore të kandidatëve.

Me përfundimin e kësaj procedure, Komisioni shpall menjëherë emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit, të Kuvendit dhe të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Në të njëjtën kohë, Komisioni i komunikon individualisht kandidatëve plotësimin/mosplotësimin e kushteve ligjore. Kundër këtij vendimi të Komisionit, kandidatët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë, sipas parashikimeve të neneve 32 dhe 130 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e Qeverisjes së sistemit të Drejtësisë".

3. Vlerësimi i kriterëve profesionale e morale të kandidatëve dhe Seanca dëgjimore

Për kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore, Komisioni vazhdon me vlerësimin e kriterëve profesionale e morale.

Në vijim Komisioni zhvillon një intervistë të strukturuar me gojë me kandidatët, ku për verifikimin e aftësive të kandidatëve, i interviston ata, vetë ose nëpërmjet ekspertëve, sidomos për të verifikuar nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, veçanërisht kur nuk ka dëshmi nga institucionet përkatëse.

4. Renditja e kandidatëve

Pas vlerësimit të kriterëve profesionale e morale të kandidatëve dhe intervistimit të tyre, Komisioni bën renditjen e kandidatëve, jo më vonë se 10 ditë nga dita e mbledhjes. Në marrjen e vendimit për renditjen e kandidatëve, Komisioni ndjek kriteret e parashikuara në ligjin nr.115/2016, si dhe në procedurat e parashikuara në këtë Rregullore. Në përfundim të këtij procesi Komisioni harton një raport të arsyetuar për renditjen e kandidatëve.

5. Përcjellja e listave të kandidatëve

Në përfundim të procesit të vlerësimit, Komisioni miraton me Vendim raportin e arsyetuar të renditjes së kandidatëve. Kryetari Komisionit i përcjell këtë raport Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, së bashku me një listë me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta, por jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante.

Lista me emrat e renditur të kandidatëve dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore, si dhe raporti i vlerësimit, i dërgohen për regjistrim protokollit të Kuvendit të Shqipërisë, së bashku me kopjet origjinale, ose të noterizuara, të dokumentacionit të çdo kandidati, së bashku me inventarin e dosjes së tij.

Neni 20

Kriteret profesionale dhe morale për renditjen e kandidatëve

1. Renditja e kandidatëve do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi, duke u mbështetur në kriteret e parashikuara nga ligji nr.115/2016.
2. Detajimi i mëtejshëm i kriterëve dhe caktimi i peshës specifike të tyre, do të caktohen me Vendim të veçantë të Komisionit.

Seksioni 3

Transparenca dhe komunikimi

Neni 21

Komunikimi pas verifikimit të kandidatëve

Me përfundimin e procedurës së verifikimit paraprak, Komisioni:

1. shpall menjëherë emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit.
2. i komunikon individualisht kandidatëve rezultatin e verifikimit të të dhënave të deklaruara si dhe plotësimin/mosplotësimin e kushteve ligjore.
3. i dërgon për publikim Kuvendit dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, listën e emrave të kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 22

Komunikimi me publikun dhe institucionet

1. Komisioni komunikon me publikun pas çdo mbledhjeje përmes një komunikate për mediat dhe sipas natyrës së çështjeve të trajtuara, informon së paku për:
 - a) kohën e zhvillimit të mbledhjes;
 - b) pjesëmarrjen dhe çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës;
 - ç) përmbajtjen e vendimmarrjeve të Komisionit
2. Pas përfundimit të procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidatëve, në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit publikohet shkresa që kryetari i Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* i përcjell Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, e cila përmban listën me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta dhe listën me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore.
3. Njoftimet për publikun përgatiten nga kryetari i Komisionit, i cili merr paraprakisht mendimin e anëtarëve. Kryetari i Komisionit urdhëron publikimin e njoftimit brenda 24 orëve nga zhvillimi i mbledhjes.

Seksioni 4

Veprimtaria përgatitore dhe mbështetëse për Komisionin

Neni 23

Personeli administrativ dhe detyrat e tij

1. Komisioni ndihmohet në veprimtarinë e tij nga personeli administrativ i institucionit të Avokatit të Popullit, i cili do të shërbejë edhe si Sekretariat teknik për Komisionin, deri në përfundim të të gjithë procesit për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve.
2. Përveç sa u kërkohet, rast pas rasti nga kryetari i Komisionit, personeli administrativ mbështetës kryen veprime lidhur me hartimin e procesverbaleve të mbledhjes, hartimin e projektshkresave apo projektakteve të ndryshme të Komisionit, hartimin e projekt-njoftimeve për shtyp, mbajtjen e arkivës dhe protokollit të Komisionit, dërgimin dhe ndjekjen e njoftimeve të Komisionit, veprime të tjera të sekretarisë, veprimet për publikimin e

njoftimeve dhe akteve në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit, apo në media, si edhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e mbledhjeve dhe veprimtarive të Komisionit.

Neni 24

Regjistrat, dokumentacioni dhe administrimi i tyre

1. Të gjitha komunikimet drejtuar anëtarëve të Komisionit, si dhe komunikimet zyrtare të anëtarëve jashtë mbledhjeve të Komisionit, protokollohen në një libër të veçantë.
2. Përpara dërgimit për regjistrim në protokollin e Kuvendit të Shqipërisë, të kopjeve origjinale, ose të noterizuara, të dokumentacionit të çdo kandidati, së bashku me inventarin e dosjes së tij, në se ky dokumentacioni nuk është sjellë nga kandidatët në dy kopje, sekretaria e Avokatit të Popullit, fotokopjon gjithë dokumentacionin përkatës, duke bërë edhe vërtetimin e njësisë me origjinalin dhe ruan këtë kopje në arkivën e institucionit, sipas legjislacionit për arkivat.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin nga mbledhja e Komisionit dhe publikohet menjëherë në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit.